

## ***RAPORTI TEKNIK GAZI MEDICINAL***



### **OBJEKTI:**

***“PËRGATITJA E PROJEKT PREVENTIVIT PËR  
RIKONSTRUKSIONIN E GODINËS SË KORPUSIT QËNDROR  
DHE SISTEMIMIN E AMBJENTEVE TË JASHTME TË SUT”***

**POROSITES:**  
**SPITALI UNIVERSITAR I TRAUMES**

**PROJEKTUES:**  
**BOE “CIVIL CONS” Sh.p.k & “C.E.C Group” Sh.p.k**

**2021**

## **PERMBAJTJA**

<b>1</b>	<b>IMPIANTI I GAZIT MEDIKAL.....</b>	<b>3</b>
1.1	Impianti i gazit mjeksor .....	3
1.2	Ambienti teknik .....	3
1.3	Kalimi i Linjave .....	3
1.4	Sistemi i Shperndarjes.....	4

## **1.1 IMPIANTI I GAZIT MEDIKAL**

### **1.1 Impianti i gazit mjeksor**

**Impianti i gazit mjeksor** në vetvete përfshin sistemin e shpërndarjes së gazrave si: oksigjeni (O<sub>2</sub>), ajri medical (CA), vakuumi (V) dhe gazi narkotik-protoksidi i azotit (N<sub>2</sub>O) në mënyrë të specifikuar në kërkesat medikale për çdo ambient mjekësor sipas kërkesave normative Europiane, pamvaresisht përdorimit të metodave alternative të anesteziës etj.

**Këto sisteme respektivisht** janë të përbërë nga impianti teknik, i cili është vendosur në ambientin teknik. Në këtë ambient është parashikuar centrali i ajrit mjeksor dhe centrali i vakumit, ndërsa rezervuari i oksigjenit është parashikuar në plansistemim sipas normave të sigurisë. Temperatura e ambientit në të cilat janë pozicionuar cilindrat e depozitave nuk i kalon 50 °C, ndërsa temperatura e ambientit në të cilin është pozicionuar kompresori, pompat evakumit është 10 °C ÷ 40 °C. Gjithashtu është parashikuar që të bëhet ndërrimi i ajrit në mënyrë të vazhdueshme. Ky impiant është projektuar i veçantë dhe është i destinuar vetëm për impiantin e gazrave mjeksore.

### **1.2 Ambienti teknik**

**Ambienti teknik** ku janë pozicionuar pajisjet e gazit mjeksor pozicionohen në ambiente që i plotëson kushtet teknike, sipas normave dimensionale dhe ndertimore, normave të temperaturës, lagështisë, ventilimit natyral të vazhdueshëm të ambientit. Gjithashtu respekton distancat midis bombolave për çështje sigurie dhe distancën ndërmjet godinës (bombolat e oksigjenit janë rreth 25m larg godinës së spitalit), janë të pajisura me pajisjet furnizuese rezerve dhe emergjence, të cilat janë destinuar vetëm për impiantet e gazit mjeksor.

### **1.3 Kalimi i Linjave**

**Kalimi i linjave** nga godina teknike deri në godinën e spitalit bëhet nëpërmjet kolektorëve që arrijnë në centralin e reduktimit të shkallës së parë të gazit mjeksor të vendosur në hyrje të spitalit. Nga ky nënstacion nis rrjeti i shpërndarjes për të gjithë destinacionet për spitalin me rrjetin reduktimit të shkallës së dytë, me pajisjet ndërmjetëse të kompletuar me sistemin e alarmit etj., me rrjetin e tubacioneve të shpërndarjes deri tek daljet për përdoruesit, prizat e lidhjes të testave ose konsolat etj. Rrjeti i shpërndarjes është konformë normave të instalimit, dhe materiali i tubave sipas karakteristikave të përcaktuara në normat dhe kushtet teknike.

#### **1.4 Sistemi i Shperndarjes**

**Sistemi i shpërndarjes** të gazit mjekësor është në përputhje me kompartmentizimin e zjarrit dhe siguron ndërprerjen e furnizimit të gazit përmes pajisjes mbyllëse manuale të vendosur jashtë çdo kompartimenti. Gjithashtu sistemi është i pajisur edhe me tregues në rast ndërprerje apo ndërhyrje në sistem

***PERGATIUR NGA:***

BOE “CIVIL CONS ” SH.P.K & “C.E.C GROUP” SH.P.K